

TRYSNIA E HUAJ MBI SHQIPEN STANDARDE

(THE EXTERNAL PRESSURE ON STANDARD ALBANIAN LANGUAGE)

Raul LILO

Departamenti i Gjuhës Frënge, Universiteti i Tiranës, Tiranë,
SHQIPËRI

E-mail: raullilo@hotmail.com

PËRMBLEDHJE

Pas viteve '90 të shekullit XX, trysnia e huaj në shqipen standarde është rritur ndjeshëm. Në rrethanat e reja të kontakteve të shumta ndër-gjuhësore, një mori fjalësh me prejardhje të huaj, shumë prej të cilave të panevojshme, kanë lëshuar rrënjë në leksikon e shtetarëve, politikanëve, gazetarëve etj. Por, nga ky vërshim fjalësh të huaja, nuk është prekur vetëm leksiku, i cili ka veçorinë dalluese për të qenë një nënsistem përherë dhe më i hapur. Në këtë ballafaqim të shqipes me gjuhët e huaja, sidomos me angloamerikanishten, janë prekur edhe rrafshet e tjera të gjuhës, si morfologjia dhe sintaksa. Studiuesit e gjuhës shqipe kanë bërë klasifikime të ndryshme lidhur me huazimet, kryesisht sipas fushës, ligjëritimit, mënyrës së huazimit, përmbajtjes së huazimeve etj. Nga këndvështrimi ynë fjalët e huaja mund t'i grupojmë në huazime objektive dhe subjektive. Në grupimin e parë bëjnë pjesë huazimet denotative, që u përgjigjen nevojave të reja pas ndërrimit të sistemeve e zhvillimeve politike, ekonomike, shoqërore e kulturore në vend. Këtu përfshihen edhe ndër-kombëtarizmat. Ndërsa për grupin e dytë mund të përmendim huazimet që cilësohen si përdorime të çastit, si modizma, si huazime-aluzione etj. Por, sa rrezikohet shqipja standarde nga trysnia e huaj? A cenohet gjuha shqipe edhe nga vetë shqiptarët? Çfarë masash

duhet marrë për ruajtjen dhe pasurimin e saj?

Fjalët kyçe: *huazim, trysni, tipologji, leksik, masa.*

Key words: *loanword, pressure, typology, vocabulary, measures.*

Është krejt e natyrshme që në periudha ndryshimesh të mëdha politike, ekonomike e sociale, në periudha kthesash historike në jetën e një kombi, të ndodhin edhe zhvillime të shumta në gjuhën e tij, veçanërisht në sistemin leksikor. Pasurimi i leksikut, sidomos i disa fushave të tij (si, politika, teknologjia e informimit, financa, arti etj.) me fjalë e kuptime të reja, është një prej ndikimeve positive, që vjen si pasojë e kontakteve të shumta e intensive të shqipes me gjuhët e kulturat e popujve të tjerë. Por, këto lidhje mbartin edhe pasojat e tyre negative, çka duket qartë në përdorimin abuziv, pra, të panevojshëm, të pamotivuar, të një morie fjalësh e ndërtimesh me prejardhje të huaj. Një pohim i tillë po përvijohet dita-ditës në realitetin shqiptar, ku vërejmë me keqardhje se mjaft fjalë të huaja që shpesh bien ndesh me sistemin gramatikor të shqipes, përdoren me shumicë jo vetëm në ligjërimin e folur, por edhe në gjuhën e shkruar. Fjalë të tilla si : *anunçim, akomodim, implementim, bord, draft, lidership, mazhorancë (ose maxhorancë), lob, luk, monitorim etj.*, bëjnë pjesë në "ortekun"

e huaj që i kanoset shqipes aktualisht. Një nga veçoritë kryesore në publicistikën e sotme është jo vetëm krijimi i një numri të madh risish me anën e mjeteve dhe mënyrave fjalëformuese të brendshme të shqipes, por edhe përdorimi i shumë huazimeve në vend të fjalëve të njohura dhe të motivueshme të fjalorit aktiv të shqipfolësve.

Por, cilat janë arsytet që në faqet e shtypit të përditshëm përballemi me lloj-lloj huazimesh si pasojë e ballafaqimit të shqipes me gjuhët dhe kulturat e vendeve të tjera? Ndër arsytet kryesore të kësaj dukurie mund të përmendim snobizmin, tiparin ekzotik të fjalës së huaj, maninë “për të rënë në sy”, njëfarë gjuhëzimi ndaj së huajës apo më keq akoma, njohjen e cunguar të visarit të shqipes dhe moszotërimin në masën e duhur të ndajshesave dhe modeleve fjalëformuese të saj. Si rrjedhojë, në shtypin e përditshëm dhe radio-televizion ndeshim gjithmonë e më shpesh :

- *kartë identiteti* në vend të *letërnjoftim*
- *inkuadroj* në vend të *përfshij*
- *bilateral* në vend të *dypalësh*
- *kualitet* në vend të *cilësi*
- *postzgjedor* në vend të *paszgjedor*
- *impresionues* në vend të *mbresëlënës* etj.

Nga ky këndvështrim, në suazën e kësaj kumtese me karakter sinkronik, do të përpiqemi të trajtojmë e të argumentojmë me fakte konkrete, të vjelura në shtypin e përditshëm gjatë tetëmbëdhjetë viteve të fundit (1990-2008), **tipologjinë e huazimeve dhe cenimin që i bëhet gjuhës shqipe nga vetë shqiptarët**. Në këtë kuadër do të mundohem gjithashtu të parashtoj edhe **disa rekomandime për ruajtjen e pastërtisë së gjuhës shqipe në periudhën e sotme të zhvillimit dhe pasurimit të saj**.

I. TIPOLOGJIA E HUAZIMEVE

Studiuesit dhe lëvruesit e gjuhës shqipe kanë bërë klasifikime të ndryshme për huazimet, kryesisht sipas fushës (huazime *morfologjike, sintaksore, leksikore* e *fonetike*) ; sipas mënyrës së huazimit (huazime të *drejtpërdrejta* e të *tërthorta*); sipas ligjëritimit (huazime *gojore* e *shkrimore*); sipas shkallës së depërtimit në sistemin e gjuhës (huazime të *rrënjësura* e të *parrënjësura*); sipas përmbajtjes së huazimeve (huazime të *plota* e *strukturore*) etj.

Natyrisht, caqet e një kumtese nuk lejojnë që të trajtohen të gjitha llojet e huazimeve me imtësi. Prandaj, në kumtesën time unë do të ndalem përmbledhtazi vetëm në disa zhvillime e prirje lidhur me përdorimin e huazimeve pas viteve '90 të shekullit të kaluar e në vijim. Tipologjia e huazimeve që parashtruam mund të plotësohet edhe me klasifikimin sipas shkaqeve a kërkesave që i nxitin shqipfolësit të përdorin me shumicë huazime si në gjuhën e folur dhe në atë të shkruar. Nga kjo pikëpamje, ato mund t'i grupojmë në huazime *objektive* dhe *subjektive*.

Në grupimin e parë bëjnë pjesë huazimet *dobi-prurëse*. Mund të veçojmë këtu huazimet *denotative* që depërtojnë në shqipen e sotme si pasojë e zbrazëtime të saj për të emërtuar ato dukuri, koncepte, organizma a objekte që u përgjigjen nevojave të reja pas ndërrimit të sistemeve, zhvillimeve politike, ekonomike, teknike e shoqërore dhe hapjes së vendit ndaj botës perëndimore. Këtu, për mendimin tonë, përfshihen edhe *ndërkombëtarizmat* të cilat, në rolin e një burimi plotësues, po ndikojnë drejtpërdrejt në «perëndimorizimin» e leksikut të shqipes moderne. Ndërkombëtarizmat në përgjithësi janë fjalë-terma, për të cilat gjuhët që ecin me ritmin e kohës kanë nevojë. Fjalët me shtrirje ndërkombëtare që po zënë rrënjë në shqipen e sotme janë rrjedhojë logjike e ndikimit ekonomik, politik, shkencor, kulturor etj. të vendeve të zhvilluara e në veçanti të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Si huazime *objektive* mund të përmendim: *globalizëm* (globalizëm ekonomik), *marketing*, *tender*, *internet*, *kompjuter*, *celular* (për më tepër hasim dhe shkurtesën *cel*), *PNUD*, *OJQ*, *klonim*, *sanduiç*, *hamburger*, *motel* etj. Është pozitiv fakti që mjaft huazime *objektive* i gjejmë tashmë të pasqyruara në fjalorët e rinj shpjegues të shqipes, botuar në vitet e fundit.

Për grupin e dytë do të përmendim disa raste:

a. Huazime që mund t'i cilësojmë si *përdorime të çastit*, sipas shijeve a synimeve të përdoruesit. Arsyet që parashtruam më sipër bëjnë që në shtypin e përditshëm e radio-televizion të ndeshim:

- *obstruksioni* i parlamentit në vend të *bllokimi* i parlamentit;

- *eskalimi* i situatës në vend të *përshkallëzimi* i situatës;

- demilitarizimi i zonës në vend të çmilitarizimi i zonës;

- përbën një *handikap* në vend të përbën një *pengesë*;

- *konfrontimi* me bazën në vend të *ballafaqimi* me bazën etj.

Si përdorime të çastit mund të cilësohen edhe huazimet *konotative* të cilat vijnë si rezultat i përvetësimit a përshtatjes me qytetërimin dhe kulturën perëndimore, si për shembull: *luk, axhendë, T-shirt, shopping, lob* etj. Kjo dukuri është kryesisht pasojë e faktit se gjuha standarde përballet sot me një kontekst tjetër kulturor.

b. *Modizmat*, të cilat janë risi ose më shpesh risi huazimesh që kanë si tipar dallues përkohshmërinë. Ato përhapen gjërësisht, njëlloj si moda, në një kohë të caktuar. Çdo periudhë mbart *modizmat* e saj, të cilat spikatin mes huazimeve të tjera për arsye të rrethanave a lëvizjeve të veçanta politiko-shoqërore ku ato jetësohen, arrijnë kulmin e përdorimit, para se të lihen në harresë. Kësisoj, në fillim të viteve '90 shumë politikanë cilësoheshin nga kundërshtarët e tyre politikë si *kriptokomunistë* (fr. *cryptocommuniste*). Po sot? Mund të pohojmë se kjo fjalë është lënë jashtë terminologjisë politike. Po kështu në gjashtëmujorin e dytë të vitit 1997 u përhap rrufeshëm fjala e huaj *meritokraci* (fr. *meritocratie*), e cila aktualisht ka dalë pothuajse jashtë përdorimit. Në një shkrim të mëparshëm kam përmendur fjalën *katarsis* (fr. *catharsis*; gr. *katharsis*), me të cilën në 2001 "u dashuruan" mjaft politikanë, militantë partish e gazetarë. Po a mund të flitet sot rreth "lëvizjes për katarsis"? Dy nga shembujt tipikë të "modizmit" në shqipen bashkëkohore janë fjalët *kleptokrat* dhe *kleptokraci* të cilat janë përdorur shpesh nga kryeministri aktual i vendit. Edhe fati i kësaj fjale të huaj ka filluar të përvijohet. Ndërsa kohët e fundit po përdoret gjërësisht kalku *kapja e shtetit* (ang. *state capture*). Është për t'u theksuar fakti se suksesi i fjalëve me burim të huaj, qoftë ky edhe i përkohshëm, varret ndjeshëm nga përdoruesit-autorë të tyre. Në shembujt e lartpërmendur janë drejtuesit dhe ish-drejtuesit e lartë të shtetit ata që kanë ndikuar në përhapjen e shpejtë të *modizmave*.

c. Huazimet-*aluzione* janë fjalë ose shprehje që tërthorazi e shpesh në mënyrë metaforike

lënë të nënkuptosh diçka a dikë. Në raste të tilla, fjala ose shprehja përmban një element të njohur paraprakisht. Shpesh *aluzionet* kanë lidhje me tituj a slogane të njohura ose me ngjarje të bujshme, kryesisht politike. Kështu, shembulli:

"Shkëlqimi dhe rënia e trupave teatrore private" (Ballkan, 1.2.2004, f. 29) na kujton nga njëra anë romanin e Balzakut *Splendeurs et misères des courtisanes* dhe nga ana tjetër gazetari krahason periudhën e vështirë që po kalon sot teatri privat me gjëndjen e kurtizaneve të shekullit XIX. Po kështu:

"Duke pritur një Falkone shqiptar..." (*Panorama*, 18.4.2004, f. 8) na risjell në mendje jo vetëm veprën e Beketit *En attendant Godot*, por përcjell te lexuesi edhe shqetësimin se: A do të kemi edhe ne Falkonet tanë për goditjen e krimit të organizuar?

"Babaramogate në sfondin shqiptar" (*Ballkan*, 17.10.2003, f. 1) na rikujton së pari çështjen "Watergate" dhe pasojat politike që ajo pati në ShBA (ish-presidenti Nikson dha dorëheqjen në vitin 1974) dhe së dyti nënkupton skandalin politik ku u përfshi ish-drejtuesi i Ministrisë së Rendit Publik.

Huazime aluzionesh përbëjnë edhe dy shembujt që vijojnë: "Gjeniu dhe Tre Muskietierët" (revista *Jeta*, n. 42, 2004, f.15); "Kali i Trojës në Korridorin 8" (*Shekulli*, 23.04.2004, f. 1).

d. Huazime që përdoren *me nxitjen e sistemit fjalëformues* hasen shpesh, sidomos në shtypin e përditshëm. Ato janë kryesisht huazime ndajshitesash fjalëformuese: parashtesa dhe prapashitesa që shquhen në përgjithësi në krijimet individuale dhe rastësore si p.sh. *celularomania* (*Shekulli*, 15.3.2004, f. 17), *superorganizatë* (*Zëri i Popullit* 21.3.2003, f. 1), *minikoncert* (*Shekulli*, 18.4.2003, f. 24), situata *postzgjedhore* (*Korrieri*, 3.11.2003, f. 2), plan *hiperspecial* (*Koha Jonë*, 5.2.2004, f. 5) etj.

II. SHMANGIET NGA NORMA

Duke u nisur nga hulumtimet dhe gjurmimet tona të vazhdueshme në këtë periudhë shtatëmbëdhjetë vjeçare (1990-2007) të zhvillimit të shqipes standarde dhe zgjerimit të pandërprerë të leksikut të saj, në përgjithësi vihet re se norma gjuhësore dhe ajo leksikore në veçanti karakterizohet nga një dinamizëm i vijueshëm.

Është tepër domethënës dhe pozitiv fakti se

shumë analistë, opinionistë, gazetarë, politikanë, shtetarë, intelektualë, veprimtarë shoqërorë dhe shumë të tjerë që shkruajnë në organet e shtypit, zotërojnë gjuhë të huaja. Por, nga ana tjetër, është po aq i vërtetë dhe i hidhur fakti se, në të shumtën e rasteve, janë ata që japin të parët shembullin e keq duke përdorur me shumicë, vend e pa vend, fjalë të huaja të panevojshme dhe “shqipvrasëse”. Kësisoj, një nga dukuritë kryesore që shfaqet veçanërisht për normën leksikore në gjuhën e shtypit, nuk është vetëm prania e tepruar e fjalëve me burim të huaj, por sidomos prirja e snobëve për të përdorur huazime në vend të fjalëve shqipe tepër të njohura, të ditura dhe të kuptueshme nga bashkësia shqipfolëse.

Në këto kushte vihet re lehtësisht **tepria dhe shtimi artificial dhe i papërligjshëm i dysorëve në faqet e gazetave tona**. Kjo përbën në thelb një dukuri të dëmshme të këtyre viteve, pasi pjesa dërrmuese e mjaft fjalëve të huaja që janë rishfaqur aktualisht ishin zëvendësuar bindshëm para viteve '90 me fjalët shqipe përkatëse. (p.sh.: *ambient / mjedis, experience / përvojë, ekspresiv / shprehës, eveniment / ngjarje, risk / rrezik, koncentrim / përqëndrim* etj.)

Por, huazimania arrin kulmin në rastet e përdorimit të **trisorëve**. Kështu, në të njëjtin shkrim, vetëm një gazetar i papërgjegjshëm për dëmin që sjell, përdor në titull *pasojë*, në hyrje *reperkusion* dhe në vijim të artikullit *impakt*. Siç shihet nga shembujt e mësipërm, në përgjithësi kuptimi i fjalës vendëse është më i qartë, me shtrirje dhe njohje më të madhe, por edhe sinonim i plotë në të shumtën e rasteve me fjalën e huaj.

Norma leksikore vazhdon të shkelet dhe të pësojë thyerje e çarje sepse ajo ndeshet sot me të huajën ; me hir e pa hir shqipja po hapet ndaj huazimeve, sidomos ndaj huazimeve të domosdoshme. Por, shpesh, bashkë me fjalët e huaja hyjnë edhe mjaft mjete fjalëformuese. Si pasojë, në shqipen e sotme vihet re prirja e gabuar që shfaqet në mënjanimin e ndajshesave fjalëformuese vendëse si **pas-, ç-, ndër-, mbi-** dhe përdorimin abuzues të parashtesave të huaja **post-, de-, inter-, super-**, edhe pse ato u përgjigjen plotësisht nga kuptimi parashtesave të huazuara nga gjuhët neolatine. Kësisoj, edhe ata që ndjekin

sadopak shtypin kanë “fatin e mirë” të ndeshin nëpër faqet e gazetave fjalë të tilla si *postzgjedhor, depolitizim, interplanetar, superfitim, supernjeri* në vend të fjalëve *paszgjedhor, çpolitizim, ndërplanetar, mbifitim, mbinjeri*, ku shihet qartë se ndajshesat vendëse zëvendësojnë më së miri ato me prejardhje të huaj. Pra, shqipja standarde me ligjësitë e saj të brendshme fjalëformuese mund të plotësojë shumë nevoja të reja leksikore që kjo periudhë shndërrimesh shumëplanëshe shtron para saj.

Përveç fjalëve e ndajshesave fjalëformuese me burim të huaj që po “pushtojnë” faqet e gazetave, duke u bazuar në sistemin fjalëformues të gjuhës shqipe, përbëjnë shmangie nga norma leksikore fjalët e formuara me ndajshesën **mos-** si *mospajtueshmëri* e *mosdurim*. Për këto dy raste norma kërkon përdorimin e fjalëve të formuara me anën e parashtesës **pa-**: *papajtueshmëri, padurim*.

III. DISA REKOMANDIME PËR RUAJTJEN DHE PASURIMIN E SHQIPES

Në periudhën e sotme të zhvillimit të shqipes, pasurimi i leksikut nëpërmjet zëvendësimit të shumë fjalëve të huaja të panevojshme me risi nga brumi i shqipes, është shprehje e zhvillimit drejt përsosjes së mëtejshme të normës leksikore në veçanti. Këtu duhen dalluar termat me shtrirje ndërkombëtare, pasi një pjesë e mirë e tyre janë përvetësuar, duke iu përshtatur natyrës gramatikore të shqipes. Vërshimi pa kufi i shumë fjalëve të huaja, sidomos në gjuhën e shtypit si *monitorim* për *vëzhgim, kredibilitet* për *besueshmëri, bipartizan* për *dypalësh, violent* për *i dhunshëm* etj., bëhet pengesë për zhvillimin e njësimin e normës.

Jam i mendimit se shqipja me mjetet dhe mënyrat e saj fjalëformuese mund të zëvendësojë edhe fjalë ndërkombëtare që kanë shtrirje e qarkullim të dendur si *kombëtarizëm* në vend të *nacionalizëm, kombëtarist* në vend të *nacionalist, përbotizim* në vend të *globalizim, perëndimorizim* në vend të *oksidentalizim* etj. Edhe gjuhëtari i shquar Eqrem Çabej ka theksuar se “janë të gjitha mundësitë për një zëvendësim të fjalëve të huaja me fjalë vendi, dhe kjo pa bjerrje aspak të vlerës kuptimore të fjalëve”.

Në këtë drejtim, ngritja e **nënkomisioneve të terminologjisë** pranë administratës qendrore do

të përbente, për mendimin tonë, një ndihmesë të çmuar jo vetëm për zëvendësimin e huazimeve të panevojshme, por edhe për të rekomanduar fjalë të reja që plotësojnë zbrazëtitë e shqipes në disa fusha të cilat i përmendëm në hyrje të kumtesës. Këto nënkomisione do të luanin një rol të rëndësishëm jo vetëm për ruajtjen e normave gjuhësore, por edhe për të orientuar zhvillimin e shqipes bashkëkohore, sepse ajo ka nevojë për përmirësime dhe të ecë me ritmin që kërkon zhvillimi i shoqërisë shqiptare sot. Për më tepër, puna e nënkomisioneve do të ishte më frytdhënëse duke bashkëpunuar ngushtë me **Komisionin Ndërad akademik** të gjuhës shqipe, i cili u krijua në Tiranë në fillim të dhjetorit 2004. Krijimi i Komisionit Ndërad akademik, i përbërë nga profesorë të njohur të gjuhës shqipe, studiues, albanologë, përbën një nismë të mirëpritur dhe një përpjekje serioze e pozitive për të gjitha problemet që shtrun sot për zgjidhje zhvillimi i gjuhës shqipe.

Një dukuri e ngjashme ekziston edhe në vendet e tjera më të zhvilluara si në Francë e gjetkë. Kësisoj, qysh në janar të vitit 1972, kryeministri francez pasi u konsultua me Akademinë franceze dhe Komitetin e lartë të gjuhës frënge dekretoi krijimin e komisioneve të terminologjisë pranë administratës qëndrore. Ato duhej të përcaktonin mangësitë që viheshin re në leksikun e gjuhës frënge dhe njëherazi të propozonin fjalët e nevojshme për emërtimin e koncepteve, objekteve dhe dukurive të reja, si dhe të jepnin rekomandime lidhur me zëvendësimin e huazimeve të panevojshme, e së pari të **anglicizmave**. Këto komisione përbëheshin nga specialistë me përvojë dhe duhej të bashkëvepronin me Këshillin Ndërkombëtar të gjuhës frënge. Më pas dolën në qarkullim mjaft botime me karakter zyrtar që përmbanin lista fjalësh duke pasur si qëllim kryesor jo vetëm zëvendësimin e huazimeve të panevojshme, por edhe krijimin e neologjizmave. Fjalët e propozuara prekin fusha të ndryshme si *ekonominë, informatikën, financën, politikën, shërbimet publike, sportin* etj.

Çdo shtet i përparuar përcakton një politikë gjuhësore të vetën dhe ngre institucione që e zbatojnë këtë politikë. Në kushtet e reja të proceseve globalizuese, hartimi i një legjislacioni gjuhësor

për ruajtjen dhe zhvillimin e shqipes merr një rëndësi të dorës së pare. Ky legjislacion të parashikojë sanksione për normëshkelësit e gjuhës e të mbrojë shqipen nga ndikimet abuzive prej gjuhëve të huaja. Siç e thekson dhe prof. Xhevat Lloshi, "gjuhëtarët të shndërrohen në veprimtarë për një kulturë shqiptare gjithnjë në ngritje".

Në organet e shtypit e veçanërisht në ato shkencore të botohen lista për zëvendësimin e huazimeve të panevojshme me fjalë vendëse. Në këtë veprimtari duhet të mbështetemi gjerësisht së pari në thesarin e fjalorit të shqipes, në rregullat e fjalëformimit të saj, por edhe në shqipërimin e fjalëve të huaja (kalket). Por, që këto shqipërime të jenë sa më të pranueshme nga folësit e shqipes, duhet synuar që kuptimi i tyre të përkojë me atë të fjalës së huaj dhe mundësisht të jetë i motivueshëm.

Një fuqi të madhe ndikuese dhe vepruese për ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës ka shtypi, radio-televizioni, ATSH-ja, shtëpitë botuese dhe shkolla.

PËRFUNDIME

Është e vërtetë që shqiptarët sot kanë një gjuhë standarde të përbashkët dhe kjo përbën, për mendimin tonë, një arritje të madhe kombëtare. Por, njëkohësisht, duhet pranuar gjithashtu se ka ardhur koha për përmirësime dhe shqipen ta shohim si gjuhë të hapur. Kjo vihet re qartazi te prirja e normave gjuhësore, e në veçanti të normës leksikore, për zhvillim e përsosje. Gjuha nuk është kurrë e përkryer, ajo është **dinamike** dhe gjithmonë në proces zhvillimi. Por, në të njëjtën kohë, nuk duhet lejuar rënia e kujdesit për gjuhën dhe çënimi i prestigjit të shqipes, e sidomos i gjuhës së shkruar. Është i pranueshëm edhe fakti se normë idealisht të njësuar nuk mund të ketë dhe se **norma leksikore në gjuhën e shtypit sot është elastike**. Norma dhe ndryshimi përbëjnë dy forca që bashkëveprojnë në gjuhë e rrjedhimisht e pasurojnë atë.

Së fundi, është tashmë e qartë për këdo se shqipja po hapet ndaj ndërhyrjeve të huaja, gjuhët dhe kulturat po japin e huazojnë në ditët tona si kurrë ndonjëherë, dhe një dukuri e tillë ndodh për shumë arsye objektive; **por kjo nuk**

duhet kuptuar sikur gjithçka që hyn duhet patjetër të pranohet dhe të kthehet në normë.

BIBLIOGRAFIA

SAMARA, M. *Norma leksikore në fjalorët shpjegues të shqipes*, Konferenca Shkencore "Leksikografia shqipe – Trashëgimi dhe perspektivë", Tiranë, 2004.

GRUP AUTORËSH, *Shqipja standarde dhe shoqëria shqiptare sot*, Shkenca, Tiranë, 2003.

MEMUSHAJ, R. *Hyrje në gjuhësi*, Dituria, Tiranë, 2002.

LILO, R. *Huazime të panevojshme në shqipen e sotme*, Sfidë/1, Tiranë, 2003.

LILO, R. *Çështje të normës leksikore në shtyp*, Konferenca Shkencore "Zbatimi i kulturës gjuhësore në shqipen e shkruar", Tiranë, 2004.

JORGAQI, K. *Thërrmija gjuhësore*, Ora, Tiranë, 2003.

Fjalor i shqipes së sotme, Toena, Tiranë, 2002.

Shtypi i përditshëm.